

KONTRATË

PËR SHËRBIMIN E MIRËMBAJTJES TEKNIKE dhe FURNIZIMI TE INTERNETIT te paisjes fiskale

Tipi i kontrates "STANDARTE" - 2 VJECARE

Sot në date ____/____/_____, Tiranë, ne palët kontraktuese vendosëm me vullnetin tonë të lirë dhe të plotë të lidhim këtë kontratë duke marrë përsipër të drejta dhe detyrime.

PALËT KONTRAKTUESE

Shoqeria e thjeshte "DAISY&ETM", me numer NIPT L04820001N, me Perfaqesuese Ligjore znj. Engjellushe Frasheri, Autorizuar nga Ministria e Financave nepermjet autorizimit me Nr.1959/4Prot., date 19/02/2019, "Për ofrimin dhe per sherbimin e mirembajtjes se pajisjeve fiskale",

dhe

Subjektit _____ NIPT _____ me Adrese: _____

_____ perfaqesuar nga _____ dhe nr. Kontakti _____

(më poshtë referuar tatimpagues).

BAZA LIGJORE:

1. Nenet 6, 419, 420, 660 të Kodit Civil;
2. Ligji Nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar me Ligjin Nr. 83/2019, date 18.12.2019, neni 122, pika 2 germa"ç"

NENI 1 – Objekti.

1. Sigurimi mirëmbajtjes teknike "Standarte" të pajisjes fiskale sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë.
2. Kjo kontratë nënshkruhet për pajisjen fiskale të modelit DAISY _____ me Nr. identifikimi të Pajisjes Fiskale :

DE _____.

NENI 2 - Çmimi dhe mënyra e pageses.

1. Vlera e kesaj kontrate 2-vjecare për shërbimet e mirembajtjes dhe furnizimi me internet e tipit "STANDARTE" te përmendura në nenin 3 është **10320 (dhjete mije e treqind e njezet)** lekë me TVSH.
2. Pagesa e kesaj kontrate do te kryhet ne momentin e lidhjes se kontrates ne nje nga dy menyrat e meposhtme:
 - a. Ne numrat e llogarise se shoqerise "DAISY&ETM" te percaktuara ne faqen 2 te kesaj kontrate, ose
 - b. Ne "cash" (para ne dore) prane zyrave te autorizuar nga Shoqeria, sipas percaktimeve perkatese ligjore.

NENI 3 – Kontrata e Shërbimit të Mirembajtjes Teknike "Standarte".

Kontrata per periudhen 2 (dy) vjecare me "Shërbimin e Mirembajtjes Teknike "Standarte" nënkupton kryerjen pa pagese te sherbimeve te perfshira me poshte:

- a. Sigurimi i internetit per transmetimin e te dhenave te gjeneruara nga kasa fiskale ne organet tatimore.
- b. Te gjitha komunikimet nepermjet thirrjeve telefonike per asistence teknike nga tekniku i autorizuar kundrejt perdoruesit (tatimpaguesi) te pajisjes fiskale.
- c. Programim i pajisjes fiskale;
- d. Riprogramim i pajisjes fiskale sipas kerkesave te klientit.
- e. Hedhje e artikujve te rinj dhe ndryshim artikuj ne pajisje fiskale (deri ne 20-30 artikuj).
- f. Trajnim personeli per perdorim te pajisjes fiskale;
- g. Azhornim te dhenash

NENI 4 - Rastet që nuk përfshin Shërbimi i Mirembajtjes Teknik "Standarte".

1. Shërbimi i Mirembajtjes Teknik "Standarte" nuk përfshin rastet e difekteve të mëposhtme:
 - a. Dëmtimet mekanike të shkaktuara nga keqpërdorimi i pajisjes fiskale si thyerje, përplasje, derdhje lëngjesh.
 - b. Dëmtimet e shkaktuara nga funksionimi i pajisjes fiskale ne ambjente me lageshtire.
 - c. Dëmtim për shkak të hyrjes së insekteve.
 - d. Dëmtimet që vijnë si pasojë e ndërhyrjeve në kasen fiskale nga persona të paautorizuar nga "DAISY&ETM".
 - e. Dëmtimet që vijnë si pasojë e goditjeve nga rrjeti elektrik (tensioni i larte dhe i ulet elektrik).
 - f. Dëmtimet që vijnë si pasojë e përdorimit të letrës së pa certifikuar nga "DAISY&ETM".
 - g. Ofrimi papagese te sherbimit prane ambjenteve te tatimpaguesit.
 - h. Ndryshim adrese te ushtrimit aktivitetit;
 - i. Programimi i pajisjes fiskale si printer fiskal;
 - j. Kryerjen e trasmetimit te te dhenave ne rast bllokimi GPRS;

- k. Dhenie programi "DPrint" per perdorimin e pajisjes si printer fiskal.
- l. Zhbllokim te pajisjes fiskale;
- m. Pastrim pajisjes fiskale nga perdorimi jo i mire i saj.
- n. Risetimin e pajisjes fiskale.
- o. Asistence teknike prane pikave te sherbimit te "DAISY&ETM".
- p. Ofrimi papagese te sherbimit prane ambjenteve te tatimpaguesit.
- q. Te gjitha rastet e tjera qe nuk perfshihen ne NENIN 3 te kesaj kontrate.

2. Ne rast difekti pjeset e pajisjes fiskale riparohen apo zevendesohen nga Shoqeria e Autorizuar DAISY&ETM vetem me pagese te bere nga tatimpaguesi (perdoruesi i pajisjes fiskale), sipas cmimeve te pjeseve te kembimit te afishuara prane pikave te sherbimit te Shoqerise se Autorizuar.

NENI 5 - Të drejtat dhe detyrimet e Shoqerisë së Autorizuar.

1. Te siguroj sherbimin e mirëmbajtjes teknike se Pajisjes Fiskale nëpërmjet qëndrave të shërbimit, Cdo kerkese per ofrimin e ketij sherbimi prane ambjenteve te tatimpaguesit do te kete nje tarife shtese prej 2700 (dymije e shtateqind) leke per cdo rast krahas percaktimeve te nenit 3 dhe 4 te kesaj kontrate.
2. Te siguroje sherbimin e internetit nepermjet operatorit te kontraktuar per transmetimin e te dhenave
3. Të sigurojë shërbim dhe asistencë teknike nga e Hena ne te Premte deri ne oren 16:00 dhe te Shtune deri ne oren 14.00, ne perputhje me nenin 3 dhe 4 te kesaj kontrate;
4. Të sigurojë riparim të Pajisjes Fiskale brenda harkut kohor prej 48 orëve nga çasti i paraqitjes se pajisjes fiskale prane pikave te sherbimit teknik te Shoqerise se Autorizuar.
5. Të plotësojë Librin e kases per cdo rast kur tatimpaguesi sjell pajisjen fiskale per sherbim prane pikave te sherbimit.
6. Te refuzoje sherbimin per subjektet te cilet paraqiten pa liber te kases kur kerkojne sherbimin per pajisjen fiskale dhe te udhezaje tatimpaguesin per sjelljen e librit apo kompletimin me liber te ri ne rastin qe e ka humbur.
7. Të verë në dijeni administratën tatimore, në rastet kur tatimpaguesi ka ndërmarrë veprime për ndryshimin e të dhënave, kur vazhdon te kete pajisjen fiskale jashte funksionimit per pasoje e mospageses te riparimit te difekteve ne pajisjen fiskale, si dhe kur neglizhon terheqjen e pajisjes fiskale pas riparimit (48 ore pas paraqitjes ne pikat e sherbimit).
8. Të ruajë memorien siç parashikohet nga dispozitat përkatëse.

NENI 6 - Të drejtat dhe detyrimet e tatimpaguesit të pajisjes fiskale.

1. Te kerkoje asistencen teknike dhe sherbimin e internetit sipas percaktimeve ne nenin 3 te kesaj kontrate
2. Të mbajë në kushte pune pajisjen fiskale dhe të mos kryejë asnjë veprim që është në kundërshtim me ligjin;
3. Të njoftojë menjëherë Shoqerine DAISY&ETM për difektet e Pajisjes Fiskale;
4. Të mirëmbajë me kujdes Librin Fiskal dhe pasaportën teknike të pajisjes;
5. Është i detyruar të paraqesë Librin Fiskal çdo herë që teknikët e DAISY&ETM kryejnë ndërhyrje në Pajisjen Fiskale;
6. **Të përdorë vetëm letër te tregetuar nga Shoqeria e Autorizuar DAISY&ETM** në mënyrë që printimi i kuponit të bëhet me cilesi dhe të mos dëmtohet Printeri Termik;
7. Klienti ne cdo kohe mund te kaloje nga tipi i kontrates "standarte " ne kontraten " Full servis" duke bere pagesen perkatese.

NENI 7 - Vlefshmeria dhe kohëzgjatja e kontratës.

1. Kjo kontratë hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të saj nga dy palët kontraktuese të lartpërmendura si dhe pas kryerjes se pageses perkatese.
2. Efektet financiare te kesaj kontrate zgjasin per nje periudhe 1(nje) vjecare nga momenti i hyrjes ne fuqi.
3. Kontrata rinovohet periodikisht .

NENI 8 - Dispozita të fundit.

1. Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis palëve do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt zgjidhja e tyre do të jetë kompetencë e Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë;
2. Kjo kontratë hartohet në 2 kopje, firmoset nga të dyja palët dhe vuloset nga Shoqeria e Autorizuar;

PALËT KONTRAKTUESE

Tatimpaguesi

**Shoqëria e Autorizuar
"DAISY&ETM"**

BANKAT	Llogaria ne LEKE	Llogaria ne EURO
Raiffeisen Bank	0040043447 AL 94202410030000000040043447	03043447 AL 23202410100000000003043447
BKT	406427137 AL6220541066427137 CLPRCLALLA	406427137 AL2820541066427137 CLPRCFEURS
Societe Generale	00903318 AL1021342011000000000903318	00912446 AL3121342011000000000912446
UNION BANK	329186 AL5121441103041032918602011	329186 AL4521441103041032918602012
PROCREDIT BANK	50-201934-00-01 AL66209415070000502019340001	50-201934-01-02 AL55209415070000502019340102